Në bazë të nenit 15.2.8 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Qiramarrësi, Viva Fresh shpk, duhet të dorëzoj në AKP garancionin bankar si masë sigurie në vlerë prej 440,000.00 euro, bazuar në raportin e kompanisë vlerësuese PMB Global lidhur me ndryshimet strukturore në asetin e NSh Metaliku Ena në Gjakovë.**

II. **Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të konfiskoj garancionin bankar në rast se ndërpritet kontrata e qirasë dhe qiramarrësi nuk i kthen asetet në gjendjen ekzistuese.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me qiramarrësin, Viva Fresh sh.p.k, i cili kishte bërë rrënimin e objektit të Drejtorisë dhe ndryshimet strukturore te objekti i vegëltorës pa lejen paraprake nga AKP-ja dhe nga ky qiramarrës më datë 28 prill 2022 është kërkuar që të bëj ndërprerjen e punimeve për të cilat nuk ka marrë leje paraprake nga AKP-ja për të bërë ndryshimet strukturore.

Qiramarrësi, Viva Fresh sh.p.k, më datën 10 maj 2023 ka dorëzuar shkresën me numër protokolli 1585 në AKP ku ka theksuar se deri te rrënimi i objektit të Drejtorisë ka ardhur si rezultat i shtyllave të dëmtuara dhe rrezikut të përdorimit të atij objekti në formën dhe strukturën që ka pasur. Prandaj për shkaqe të sigurisë kanë bërë rrënimin e atij objekti dhe për këtë ata pranojnë që të ofrojnë garancion bankar në rast të ndërprerjes së kontratës së qirasë dhe mos kthimi të aseteve në gjendjen paraprake. Për këtë ata kanë dorëzuar një raport vlerësimi nga një kompani të cilën e kanë angazhuar vetë dhe ku sipas asaj kompanie kostoja e rindërtimit të këtyre dy objekteve është 133,826.00 Euro. AKP nuk ka pranuar raportin e vlerësimit të dorëzuar nga qiramarrësi dhe ka angazhuar kompaninë vlerësuese e cila ka bërë vlerësimin e kostos së ri ndërtimit të këtyre objekteve dhe se konsiderohet se pas përmbushjes së kërkesave për garancion bankar qiramarrësit duhet ti lejohet kryerja e punimeve në asetet e marra me qira. Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-186/23

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet zbritja e sipërfaqes prej 887 m² nga kontrata bazë në sipërfaqe prej prej 53856 m², për parcelën e marrë me qira nga Mac Solutions për asetin e NSH "Metaliku", dhe zbritjen e vlerës së qirasë prej 88.70 euro në muaj nga vlera aktuale mujore prej 5,385.60euro, ku shuma për tu paguar nga qiramarrësi do të jetë 5,296,90 euro. Kjo zbritje do të zbatohet nga 01.02.2023.**

II. **Aprovohet zbritja e sipërfaqes së qirasë prej 123 m² nga kontrata bazë për objektin e neutralizimit të marrë me qira nga Alfa Minerals për asetin e NSH "Metaliku", në sipërfaqe 850m2dhe zbritja e vlerës së qirasë prej 60.27 euro në muaj, përkatësisht shuma për tu paguar nga qiramarrësi Alfa Minerals do të jetë 356.28 euro. Kjo zbritje do të zbatohet nga 01.04.2022.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me kërkesën për zbritjet të sipërfaqes nga kontrata bazë për objektin e neutralizimit dhe për parcelën 116-1, pronë e NSH Metaliku Gjakovë. Qiramarrësi Mac Solutions ka kërkuar që hapësira ku janë të vendosura objektet e neutralizimit dhe objekti i trafos në sipërfaqe prej 88.7m2 të zbritet nga hapësira e përgjithshme e tokës prej 53856m2, në mënyrë që të vazhdon tutje me kryerjen e obligimeve kontraktuese.
Sipas matjeve gjeodezike, zbritja e sipërfaqes nga kontrata bazë e parcelës 116-1 të cilën e ka me qira Mac Solutions do të jetë 887m2, që në vlerë monetare do të jetë 88.70 euro.
Zbritja e sipërfaqes nga kontrata bazë e objektit të neutralizimit te cilin e ka me qira Alfa Minerals do të jetë 124m2, që në vlerë monetare është 60.27 euro.
Totali i zbritjes nga kontrata bazë e qirasë për dy asetet e Ndërmarrjes Metaliku, në vlerë monetare do të jetë 148.97 euro.
Kontrata e qirasë me Mac Solution për pronën/tokën 116-1 është në vlerë prej 5,385.60 euro.
Pas zbritjes së sipërfaqes, kontrata e qirasë për Mac Solution do të jetë në vlerë prej 5,296.90 euro (5,385.60-88.70 = 5,296.60€). Kjo vlerë do të zbritet nga data e fillimit të kontratës prej 01.02.2023.

Kontrata e qirasë me Alfa Minerals për objektin e neutralizimit është në vlerë prej 416.55 euro.
Pas zbritjes së sipërfaqes, kontrata e qirasë me Alfa Minerals do të jetë në vlerë prej 356.28 euro (416.55-60.27=356.28€). Kjo llogaritje e vlerës së zbritur të qirasë do të zbatohet nga 01.04.2022 kur edhe janë bartur elementet kimike në ndërtesa e neutralizimit. Me qëllim që qiramarrësi, Alfa Minerals dhe Mac Solutions, të vazhdojnë me kryerjen e obligimeve kontaktuese dhe evitimin e shkakut për mos pagesë të qirasë, për shkak të kërkesave të vazhdueshme për zbritjen e sipërfaqeve të lartcekura, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

MH

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-186/24

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitjen Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet rekomandimi i Njësisë për Negocim Direkt dhe udhëzohet Menaxhmenti/NjND që për katër (4) rastet të cilët kanë bërë pagesë të plotë por jashtë afatit të vazhdohet me procesin e përmbylljes së kontratave me palët.**

II. **Katër (4) rastet e pagesave të pjesërishme brenda afatit 60 ditor, ju zgjatet afati për pagesë për përmbushjen e pjesës së mbetur edhe për tridhjetë (30) ditë nga dita e aprovimit të këtij vendimi.**

III. **Rastet të cilat nuk kanë bërë pagesë fare as pas afatit shtesë 60 ditor të vazhdohet me procedurat tjera ligjore të parapara në Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitjen Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.**

IV. **Për rastin e z. Jakup Kurti të tërhiqet kallëzimi penal i iniciuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit.**

V. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Duke pas parasysh vendimin e Bordit nr. ref. BD-179-28 të datës 27 Prill 2023 ku Bordi kishte lejuar afat shtesë 60 ditor për disa raste të vonesave në pagesë për rastet e negocimit direkt, Bordi i Drejtorëve të AKP-së në ndërkohë ka kërkuar raport shtesë për zbatueshmërinë e vendimit në fjalë. Pas shqyrtimit të raportit informues nga Menaxhmenti dhe Njësia dhe në bazë të kompetencave ligjore të parapara në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115 dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitjen Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 04 shtator 2023

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-186/25

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullorës nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore të datës 31 gusht 2022, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa e Telekomit të Kosovës për zbritjen e vlerës së qirasë për shkak të mos shfrytëzimit të energjisë elektrike nga NSH Inex Sharr Planina Brezovicë, prej 525.00 euro në 350.00 euro në muaj që prej fillimit të kontratës 01.12.2022 e tutje.**

II. **Refuzohet kërkesa e Telekomit të Kosovës për ndryshimin e datës se fillimit të qirasë nga 01.12.2022 në 01.07.2023;**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me kërkesën e Telekomit të Kosovës për asetin e NSH Inex Sharr Planina Brezovicë

Pas kërkesës së Telekomit të Kosovës për zbritjen e vlerës së qirasë për pjesën e energjisë elektrike që paguan te operatori tjetër ekonomik, janë kërkuar informata shtesë nga menaxhmenti i ndërmarrjes për të përcaktuar nëse antenat e vendosura në kulm të Hotel Molikës shfrytëzojnë energjinë elektrike që i faturohet Hotel Molikës apo ato nga KEDS–i faturohen ndonjë operatori tjetër. Nga përgjigja e marr nga Drejtori Menaxhues i NSH Inex Sharr Planina theksohet se rryma për antenat e vendosura nuk i faturohet Hotel Molikës por një operatori tjetër, prandaj edhe ndërmarrja nuk ka asnjë shpenzim për këtë. Nga ana tjetër, Telekomi i Kosovës sh.a, ka dërguar një kontratë me një operator ekonomik në bazë të cilës qiraja mujore që paguajnë për energjinë elektrike dhe fijet optike është 240.00 euro në muaj. Por edhe përkundër kërkesës që të përcaktojnë proporcionin e pagesës për energji elektrike dhe fije optike ata nuk kanë mundur të bëjnë një ndarje të tillë.
Qiraja mujore e që aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së për antenën e vendosur në Hotel Molika është 525.00 Euro. Në raportin e vlerësimit të komisionit vlerësues vlera e qirasë pa energji elektrike ka qenë 350.00 euro dhe shpenzimi mesatar për energji elektrike është llogaritur të jetë 175.00 euro. Pas informatatve të konfirmuara se energjia elektrike e shpenzuar nuk i faturohet NSH-së, por një operatori tjetër, atëherë vlera e qirasë mujore, pa energji elektrike rezulton 350.00 euro. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-186/26

Në bazë të nenit 15.2.8 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-11, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet kërkesa për ndërrimin e destinimit të pronës në evidencën kadastrale apo për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelat të cilat janë pronë e NSH Metaliku Ena në Gjakovë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me kërkesën e qiramarrësit Viva Fresh sh.p.k. lidhur me shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelat të cilat janë pronë e NSH Metaliku Ena në Gjakovë.

Qiramarrësi Viva Fresh sh.p.k është duke vazhduar punimet në pronën e NSH "Metaliku Ena", për realizimin e projektit të tij. Sipas qiramarrësit Viva Fresh, Komuna e Gjakovës, respektivisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka kërkuar shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe atë për parcelat si në vijim: P-70705028-04341-1; P-70705028-04341-2; P-70705028-04342-1; P-70705028-04342-2; P-70705028-04346-1; P-70705028-04347-0; P-70705028-04348-1.
Kërkesa e qiramarrësit nuk është e plotë dhe për më tepër mungon edhe dokumenti referues i Komunës së Gjakovës të cilit i referohet parashtruesi i kërkesës.
Pas shyqrtimit të rastit Agjencia nuk e sheh të arsyeshme ndërrimin e destinimit të tokës në evidencën kadastrale ndërsa i njëjti është duke zhvilluar aktivitetin e tij pa pengesë nga AKP-ja.
Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-186/27

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; neni 3.13.1 i Rregullorës Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 5.7 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Marrëveshjes së ndërmjetësimit në çështjen penale P.nr. 121/17; Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri i datës 23.02.2023, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e çmimit të qirasë të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për ngastrën kadastrale nr. 1710-0 ZK Vushtrri, pronë e NSh "Elan" MIT012, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 113.40 për një vit.**

II. **Obligohet pala shfrytëzuese, Bahri Gerxhaliu, që sipas Marrëveshjes së Ndërmjetësimit P.nr.121/17 të aprovuar edhe me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri më datë 23.02.2023 dhe në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, të paguajë shumën e qirasë të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për periudhën e shfrytëzimit janar 2006 deri më dhjetor 2013 në shumën totale prej € 907.20.**

III. **Sipas Marrëveshjes së Ndërmjetësimit, detyrohet pala shfrytëzuese që shumën prej € 907.20 ta paguajë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit mbi vendimin e Bordit të Drejtorëve.**

IV. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e Raportit të Komisionit Vlerësues për pronën e NSh "Elan" MIT012, si bazë të Marrëveshjes për Ndërmjetësim për zbatimin e Aktvendimit numër P.nr. 121/17 e aprovuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri.

Me datën 31.01.2012 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka paraqitur kallëzim penal ndaj palës Bahri Gerxhaliu për uzurpim të paligjshëm të ngastrës kadastrale nr. 1710-0 ZK Vushtrri me sipërfaqe prej 20,000 m^2 pronë e NSh "Elan" MIT012. Ngastra kadastrale përkatëse ka gjithsej 31,315 m^2, por është në komasacion. Prokuroria Themelore në Mitrovicë kishte ngritur aktakuzën P.nr.121/17 me datë 23.01.2023 ndaj palës Bahri Gërxhaliu për shkak të veprës penale uzurpim i pronës së paluajtshme nga neni 259 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Më datë 23.02.2023 Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri me aktvendimin e nxjerrë gjatë seancës gjyqësore kishte vendosur që çështjen penale P.nr. 121/17 ta referojë për ndërmjetësim.

Më datë 03.03.2023 përfaqësuesja e AKP-së ka pranuar draftin e ndërmjetësimit për shqyrtim dhe nënshkrim dhe bazuar në këtë marrëveshje të ndërmjetësimit pala B (cekur në marrëveshjen e ndërmjetësimit) obligohet

M.

që të i paguajë Agjencisë Kosovare të Privatizimit çmimin e përcaktuar nga ana e Komisionit Vlerësues dhe të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve për periudhën e shfrytëzimit prej 01.01.2006 deri më 31.12.2013.
Sipas vlerësimit të AL-së, aprovimi i çmimit të qirasë sipas përshkrimit të rastit do të mundësonte inkasimin e të hyrave duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore dhe në këtë rast do të rezultonte me zbatimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit në çështjen penale P.nr. 121/17, ku edhe pala Bahri Gërxhaliu sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit P.nr. 121/17 obligohet dhe në këtë rast zotohet që të paguajë tërë çmimin si kompensim të qirasë, të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paligjshme për periudhën janar 2006 deri në dhjetor 2013.
Në qoftë se pala nuk do të i përmbahet kërkesës së Autoritetit të Likuidimit dhe të zbatojë marrëveshjen e arritur të ndërmjetësimit, atëherë siç parashihet edhe në marrëveshjen e ndërmjetësimit, Autoriteti i Likuidimit i NSh "Elan" MIT012 do të inicojë procedurë përmbarimore ndaj palës.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-186/28

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 35980/23-out në mes të NSH "Zarije Bujic" dhe qiramarrësit Veprim Mustafa; nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht 2023 dhe 04 shtator nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e objektit punues në fshatin Pasjanë, Komuna e Parteshit me sipërfaqe prej 9532 m², me qira mujore prej 350.00 € nga Veprim Mustafa tek kompania Extra Fruit Sh.P.K. me numër unik identifikues 811587437.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për kërkesën e palës për transferim të kontratës së qirasë nga Veprim Mustafa tek Extra Fruit Sh.P.K. në të cilën ai është aksionar dhe njëherish Përfaqësues i Autorizuar. Në bazë të certifikatës së regjistrimit në ARBK, mund të vërehet që z. Veprim Mustafa është aksionar dhe Përfaqësues i Autorizuar në Shoqërinë Tregtare Extra Fruit Sh.P.K. Parashtruesi i kërkesës është i gatshëm të vazhdoj qiramarrjen dhe paguaj qiranë me rregull në emër të Extra Fruit Sh.P.K.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa. Ky aset nuk është në listën e aseteve të propozuara për fondin sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-186/29

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit të PEJ130 NSh NHT Rugova (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit PEJ130 NSh "NHT Rugova"nga rajoni i Pejës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të PEJ130 NSh "NHT Rugova" (Në Likuidim).

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-186/30

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 gusht 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Magjistrala (në likuidim) PRN032, nga Rajoni i Prishtinës.**

I. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit NSh Magjistrala (në likuidim) PRN032, nga Rajoni i Prishtinës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të NSh Magjistrala (në likuidim) PRN032, nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 gusht 2023

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-186/31

Në bazë të 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1, 18.3.2 dhe nenit 19.4 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së; nenit 3.10.4 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Rregullorja nr. 04/2023 për politikat dhe procedurat ligjore të heqjes dorë të aseteve.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e datës 27 prill 2023 kishte nxjerrë pikë veprimi që Menaxhmenti të formalizojë procedurën e heqjes dorë nga asetet e NSh-ve, qoftë me rregullore apo akt tjetër. Baza ligjore mbi të cilën bazohet procesi i heqjes dorë të aseteve të caktuara si ato problematike dhe joprofitabile është Ligji Nr. 04/L-034 i AKP-së, përkatësisht Shtojca e këtij Ligji dhe Rregullorja Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Qëllimi i hartimit të Rregullores për Politikat dhe procedurat e heqjes dorë të aseteve problematike dhe joprofitabile është që të përcaktojë procedurat për aplikimin e heqjes dorë të aseteve të caktuara problematike dhe joprofitabile dhe procedurën për vendimmarrje nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së dhe për aplikim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

Duke marr parasysh të gjitha më lartë dhe pas trajitmit të draftit të Rregullores të paraqitur nga Menaxhmenti, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - Agjencia Kosovare e Privatizimit - 20 / HQ / 08 - Prishtinë - Prishtina

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/32

Në bazë të nenit 15.1 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 Gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Bordi jep pëlqimin Komunës se Ferizajt për vazhdimin e punimeve në lidhje vetëm me sanimin e dëmeve në objektet shkollore në Rr. Agim Ramadani" përballë Pallatit të Sporteve "Bill Clinton" në Ferizaj të ndërtuara në parcelat nr. 3135-1 dhe 3135-2 ZK Ferizaj në pronësi të NSh Plantacioni i Pemëve.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likudimit për kërkesën e Komunës së Ferizajt për dhënien e pëlqimit për kryerjen e punimeve/sanimin e dëmeve në objektet shkollore përballë pallatit të sporteve "Bill Clinton" Ferizaj të NSh Plantacioni i Pemëve.

Komuna e Ferizajit në bashkëpunim me MASHT, ka filluar ndërtimin e objekteve shkollore në parcelat 3135-1 dhe 3135-2 ZK Ferizaj, objekte të cilat sipas tyre do të jenë investime në dobi të komunitetit arsimor, nxënësit dhe vet institucionin e Komunës së Ferizajit. Për të evituar dëmet e mëtutjeshme në këto objekte shkollore tanimë të ndërtuara, në mënyrë që të mos rrezikohet i tërë projekti si tërësi dhe të mbrohej investimi i deritanishëm, KK Ferizaj ka kërkuar dhënien e pëlqimit deri në shkallën e vazhdimit të punimeve vetëm për sanimin e dëmeve që janë shkaktuar deri më tani dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme në mënyrë që të parandalohen dëme të tjera. Gjithashtu Komuna ka filluar procedurat e shpronësimit në lidhje me parcelat në fjalë dhe aktualisht kjo kërkesë e Komunës është në shqyrtim e sipër pranë Ministrisë përkatëse, dhe rrjedhimisht përderisa Komuna ka pretendime që këto parcela të i shpronësojë dhe në të cilat ka filluar projekte të këtij niveli, është e arsyeshme që një pëlqim i tillë të jepej nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 korrik 2023

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-186/33

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 309 m2, pjesë e parcelës nr. 182-6, me sipërfaqe të përgjithshme 2301 m2, Zona Kadastrale Shipol, Komuna Mitrovicë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Agrokultura" Mitrovicë, me parashtruesin , nga Shipoli.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit te procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 309 m2, pjesë e parcelës nr. 182-6, me sipërfaqe të përgjithshme 2301 m2, Zona Kadastrale Shipol, Komuna Mitrovicë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Agrokultura" Mitrovicë, me parashtruesin nga Shipoli.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-186/34

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 391 m2, pjesë e parcelës nr. 182-6, me sipërfaqe të përgjithshme 2301 m2, Zona Kadastrale Shipol, Komuna Mitrovicë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Agrokultura" Mitrovicë, me parashtruesin , nga Shipoli.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 391 m2, pjesë e parcelës nr. 182-6, me sipërfaqe të përgjithshme 2301 m2, Zona Kadastrale Shipol, Komuna Mitrovicë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Agrokultura" Mitrovicë, me parashtruesin , nga Shipoli.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-186/35

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 1010m2, pjesë e parcelës nr. 182-6, me sipërfaqe të përgjithshme 2301 m2, Zona Kadastrale Shipol, Komuna Mitrovicë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Agrokultura" Mitrovicë, me parashtruesin nga Shipoli.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit te procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 1010 m2, pjesë e parcelës nr. 182-6, me sipërfaqe të përgjithshme 2301 m2, Zona Kadastrale Shipol, Komuna Mitrovicë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Agrokultura" Mitrovicë, me parashtruesin nga Shipoli.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-186/36

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 1441 m2, pjesë e parcelës nr. 1533-7, me sipërfaqe të përgjithshme 6190 m2, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Bujqësia" Fushë Kosovë, me parashtruesin nga Prishtina.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit te procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 1441 m2, pjesë e parcelës nr. 1533-7, me sipërfaqe të përgjithshme 6190 m2, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Bujqësia" Fushë Kosovë, me parashtruesin nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023.

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-186/37

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 11825 m2, për ½ e parcelës nr. 68-0, me sipërfaqe të përgjithshme 23650 m2, Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Bujqësia" Fushë Kosovë, me parashtruesin – nga Obiliqi.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit te procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 11825 m2, për ½ e parcelës nr. 68-0, me sipërfaqe të përgjithshme 23650 m2, Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë, e cila evidentohet në emrin e NSH "Bujqësia" Fushë Kosovë, me parashtruesin nga Obiliqi.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 gusht 2023

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-186/38**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-186/39

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore për organizimin e agjencisë së pavarur; nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neneve 13, 14,15, 16 të Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e nëpunësve civilë si dhe bazuar në Udhëzuesin Nr. 02/2022 Për Procesin e Riorganizimit të institucioneve publike dhe sistematizimin e nëpunësve pas ristrukturimit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Rregullorja nr. 05/2023 për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

II. Rregullorja hyn në fuqi me efekt nga data 01 Tetor 2023.

ARSYETIM

Bordi i Drejtorëve me vendimin nr. BD-171/61 në mbledhjen e mbajtur me 31 tetor 2022, ka dhënë pëlqimin dhe ka autorizuar Menaxhmentin për dërgim të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe strukturës së re organizative për mendim këshillimor te Ministri përgjegjës për administratë publike, Ministri përgjegjës për financa dhe Auditori i Përgjithshëm. Pastaj përmes vendimit BD-173-3 në mbledhjen e datës 30 nëntor 2022 Bordi kishte aprovuar Rregulloren me kusht që të hyj në fuqi me datë 01 qershor 2023.
Pas diskutimeve gjatë muajve në vijim Bordi kishe konsideruar që Rregullorja ka ende nevojë për rishikim/përmirësime, dhe përmes vendimit BD-180-1 të mbledhjes së datës 17 maj 2023 ka dhënë pëlqimin për ridërgim të Rregullores për mendim këshillimor tek organet përgjegjëse. Duke parashikuar se mund të ketë vonesa në pritje të mendimit këshillimor dhe ankesave në procedurë e sipër të punonjësve Bordi përmes vendimit BD-181-7 të mbledhjes së datës 29 Maj 2023 ka marr vendim për shtyrje të afatit për zbatimin e skemës organizative deri me datë 01 Tetor 2023. Duke qenë se procedurat për mendim këshillimor janë finalizuar, Menaxhmenti ka paraqitur Rregulloren e azhurnuar për aprovim nga Bordi.
Pas miratimit, Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës publikohet në "Gazetën Zyrtare" dhe në ueb faqen zyrtare të institucionit përkatës.
Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund ta kundërshtojnë pranë organit kompetent brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 04 shtator 2023

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës